



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 2590 Prot.

Ballsh, më 22.09.2021

VENDIM

Nr. 41 Datë 22/09/2021

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 24, DATË 25.05.2021”PËR MIRATIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË PASURISË ME NR. 9/114 ZK 1090, GODINA E ISH-NDËRRMARJES SË NXJERRJES DHE TE PËRPUNIMIT TË NAFTËS, KTHYER NË BANESA, LGJ. “5-SHKURTI”, BALLSH, MALLAKASTËR”

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, të VKM nr. 179, datë 26.02.2020 “Për rregullat, kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, “Për privatizimin e banesave dhe te objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe te ndërmarrjeve shtetërore”, urdhërit nr. 533 datë 09.12.2020 të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër “Për ngritjen e komisionit për vazhdimin e procedurave për privatizimin e banesave dhe të objekteve të kthyer në fond banese të paprivatizuara në territorin e Bashkisë Mallakastër”, i ndryshuar,

VENDOSI:

Në pikën II të Vendimit nr. 24, datë 25.05.2021 “Për miratimin e fillimit të procedurave të privatizimit të pasurisë me nr. 9/114 ZK 1090, godina e ish-Ndërrmarjes së Nxjerrjes dhe te Përpunimit të Naftës, kthyer në banesa, lgj. “5-Shkurti”, Ballsh, Mallakastër”, bëhen këto ndryshime:

- I. Procedura e privatizimit do te kryet në zbatim të rregullave dhe të etapave të percaktuara në VKM-në nr. 179, datë 26.02.2020 “Për rregullat, kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, “Për privatizimin e banesave dhe te objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe te ndërmarrjeve shtetërore”.

KRYETAR

Mbarime Isufaj

